



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCIVE
Nr. 3211, Datë 10.03.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
Nr. 588, Datë 10.03.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
Nr. 515, Datë 10.03.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Nr. 254, Datë 10.03.2014

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Midis Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave:

“Për bashkëpunimin në drejtim të parandalimit dhe të administrimit të situatave të jashtëzakonshme në veprimtarinë e sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë”.

I. Përcaktime

Në këtë Memorandum Mirëkuptimi, termat e përdorur do të kenë kuptimet ë mëposhtme:

1. "GKSF" – është Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar, i krijuar në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare";
2. "Anëtar i GKSF" – është Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim, referuar përkatësisht si MF, BSH dhe AMF), sipas përcaktimeve në nenin 30 të ligjit nr.9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare";
3. "Autoritetet" – janë anëtarët e GKSF-së dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave (referuar në vijim si ASD) që merr pjesë rregullisht në mbledhjet e GKSF-së për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrimeve sipas këtij Memorandumi;
4. "Drejtuesit e Autoriteteve" – janë personat që kryejnë funksionet e: Ministrit dhe/ose Zëvendësministrit për Ministrinë e Financave; Guvernatorit dhe/ose Zëvendësguvernatorit për Bankën e Shqipërisë; Kryetarit dhe/ose Nënkryetarit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare; dhe Drejtorit të Përgjithshëm për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave;
5. "Rrezik sistemik" – është një situatë e jashtëzakonshme që po ndodh ose pritet të ndodhë në veprimtarinë dhe/ose në infrastrukturën e sistemit financiar dhe që mund të dëmtojë rëndë aftësinë e tij për të vepruar në mënyrë të qëndrueshme, për të ofruar shërbimet e ndërmjetësimit financiar ose për të mundësuar shlyerjen e pagesave në ekonomi;
6. "Infrastrukturë sistemike" – janë institucionet financiare dhe ose çdo infrastrukturë tjetër, që mbikëqyret nga autoritetet dhe vlerësohen prej tyre si kritike për qëndrueshmërinë e gjithë sistemit financiar;
7. "Autoriteti përgjegjës" – është autoriteti që mbikëqyr segmentin e sistemit financiar ku është identifikuar apo zhvilluar rreziku;
8. "Sekretariati" – është Sekretariati i GKSF-së, që krijohet në bazë të Kreut V, paragrafi 4 të Memorandumit dhe funksionon sipas procedurave të përcaktuara në Aneksin 1 të tij;
9. "GTM" – është Grupi Teknik Mbështetës, që krijohet në bazë të Kreut V, paragrafi 5 të Memorandumit dhe që funksionon sipas procedurave të përcaktuara në Aneksin 2 të tij;
10. "Mbledhje e rregullt e GKSF-së" – është mbledhja e GKSF-së që zhvillohet çdo tre muaj;
11. "Mbledhje e posaçme e GKSF-së" – është mbledhja e GKSF-së që zhvillohet në çdo kohë, pas kërkesës së çdo anëtari, për të trajtuar një ngjarje/zhvillim me rëndësi sistemike për sistemin financiar;

II. Institucionalizimi i bashkëpunimit

1. MF, BSH, AMF dhe ASD:

- a) duke vlerësuar statusin dhe përgjegjësitë që rrjedhin në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"; të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar; të standardeve ndërkombëtare e praktikave më të mira në trajtimin e situatave të jashtëzakonshme financiare që kërcënojnë stabilitetin e sistemit financiar;
- b) duke konsideruar faktin që institucionalizimi i bashkëpunimit mes autoriteteve që drejtojnë e mbikëqyrin zhvillimet në sistemin financiar, si edhe përgatitja paraprake për trajtimin e rreziqeve sistemike ndihmojnë në trajtimin e tyre me eficiencë dhe me profesionalizëm;

vendosin të lidhin këtë Memorandum Mirëkuptimi, në kuadër të përmbushjes së objektivit të përbashkët për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

- ### 2. Nëpërmjet këtij Memorandumi, autoritetet shprehin vullnetin që të rrisin dhe të formalizojnë nivelin e bashkëpunimit. Mbështetur mbi këtë vullnet dhe në plotësim të dispozitave ligjore ekzistuese, Autoritetet do të përcaktojnë në këtë Memorandum disa procedura që plotësojnë mënyrën e funksionimit të GKSF-së, si njësi këshillimore për çështje të stabilitetit financiar.

III. Objektivat e bashkëpunimit

- ### 1. Në kuadër të ushtrimit të përgjegjësiave për sigurimin e stabilitetit financiar të vendit, Autoritetet do të konsultojnë dhe harmonizojnë veprimet, duke patur si objektiva kryesorë:
- a) parandalimin e rreziqeve sistemike;
 - b) administrimin e rreziqeve sistemike;
- ### 2. Për përmbushjen e objektivave të mësipërm, Autoritetet do të bashkëpunojnë:
- a) për të realizuar një proces të vazhdueshëm dhe të plotë të mbikëqyrjes së tregjeve, të të gjitha institucioneve financiare dhe të infrastrukturës teknike mbështetëse;
 - b) për të identifikuar në kohë zhvillimet që përfaqësojnë rrezik potencial sistematik dhe për të zbatuar, në mënyrë sa më eficiente dhe të koordinuar, veprimet e nevojshme për parandalimin e tyre;

- c) për të konceptuar dhe realizuar përmirësimin e bazës ligjore dhe nënligjore, si edhe kuadrin e veprimeve e të instrumenteve për trajtimin e rreziqeve sistemike, duke përfshirë edhe komunikimin me publikun rreth tyre;
- d) për të planifikuar dhe forcuar kapacitetet njerëzore, teknike dhe financiare, të nevojshme për administrimin e rreziqeve sistemike;
- e) për të provuar zbatimin e procedurave dhe të veprimeve të posaçme në raste krize, nëpërmjet simulimit të situatave të jashtëzakonshme financiare;
- f) për t'u konsultuar mbi ndikimin që ndryshimet e politikës institucionale të secilit autoritet, mund të kenë mbi përgjegjësitë dhe aftësitë e të tjerëve në administrimin e situatave të jashtëzakonshme;

IV. Parimet e bashkëpunimit

Bashkëpunimi i Autoriteteve në kuadër të këtij Memorandumi, do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) *realizimi i shkëmbimit të rregullt të informacionit*, që do të realizohet në zbatim të përcaktimeve e të frymës së legjislacionit në fuqi dhe nëpërmjet komunikimit të posaçëm e të rregullt mes ekspertëve të secilit institucion, në mënyrë që secili autoritet të përmbushë përgjegjësitë e tij;
- b) *përcaktimi sa më i qartë i fushës së veprimit të çdo institucioni* në situatat e parandalimit dhe të administrimit të rreziqeve sistemike, për të shmangur mungesën e veprimit, inefficiencën dhe dublimin e panevojshëm të punës, si edhe për të rritur përgjegjshmërinë;
- c) *realizimi i transparencës së përshtatshme*, në mënyrë që të forcohet besueshmëria e Autoriteteve dhe përgjegjshmëria e tyre lidhur me veprimet e realizuara;
- d) *synimi për një zgjidhje të qëndrueshme*, ku situatat e rrezikut sistematik të trajtohen, duke u mbështetur kryesisht në një zgjidhje që ofron vetë tregu, që ruan dhe nxit konkurrencën, si dhe shmang stimujt e gabuar për veprimtarinë e agjentëve ekonomikë, me qëllim ruajtjen e stabilitetit e sistemit financiar të vendit me një kosto sa më të ulët për fondet, pasurinë dhe interesin publik;

V. Funkcionimi i GKSF-së

1. Në kuadër të GKSF-së, autoritetet do të diskutojnë, konsultojnë dhe harmonizojnë veprimet për identifikimin, monitorimin, parandalimin dhe administrimin e rreziqeve sistemike.
2. GKSF do të mbledhet në:
 - a) mbledhje të rregullta; dhe/ose
 - b) mbledhje të posaçme
3. Në mbledhjet e GKSF-së, Autoritetet do të përfaqësohen nga drejtuesit më të lartë të institucioneve, të mbështetur nga personeli ndihmës. Në mbledhjet e GKSF-së mund të ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve të tjera që kanë rol ose interes për çështjet që trajton GKSF-së, duke përfshirë edhe përfaqësues të industrisë financiare. Mbledhjet drejtohen nga Ministri i Financave.
4. GKSF do të ketë një Sekretariat, i cili organizohet dhe funksionon sipas Aneksit 1 të këtij Memorandumi. Secili autoritet do t'i dërgojë paraprakisht Sekretariatit, listën e çështjeve dhe materialet që dëshiron të diskutojë në mbledhjen e radhës së GKSF-së. Përpara datës së zhvillimit të mbledhjes së GKSF-së Sekretariati do të përgatisë dhe qarkullojë materialet që do të diskutohen gjatë mbledhjes për të gjithë Autoritetet. Një prej anëtarëve të Sekretariatit do të mbajë procesverbalin e mbledhjes së zhvilluar.
5. Puna e GKSF-së do të mbështet nga Grupi Teknik Mbështetës (GTM). Organizimi dhe funksionimi i GTM-së ndodhet në dokumentin bashkëlidhur në Aneksin 2 të këtij Memorandumi.
6. Në kuadër të bashkëpunimit në GKSF, Autoritetet mund të krijojnë grupe pune të përbashkëta, që do të ofrojnë ekspertizën e nevojshme për informimin, diskutimin dhe zgjidhjen e çështjeve të trajtuara. Në këto grupe pune, nëse nevojitet, do të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të tjera të interesuara, publike dhe private. Në rastet kur gjykohet e nevojshme, grupet e përbashkëta të punës do të funksionojnë mbi bazën e procedurave që do të përcaktojnë minimalisht: qëllimin e krijimit, mënyrën dhe afatin e funksionimit dhe mënyrën e raportimit të rezultateve në GKSF.
7. Në mbledhjet e GKSF-së, secili autoritet do të shprehë vlerësimin e tij mbi çështjet që diskutohen, duke synuar konvergimin e qëndrimeve dhe të veprimeve. Për çështjet që diskutohen në mbledhjen e GKSF-së, nuk do të ketë votim. Në rastin e qëndrimeve të kundërta, nëse nevojitet, pozicionet e palëve do të shprehen me shkrim,. Në çdo mbledhje, GKSF do të vlerësojë përshtatshmërinë e nxjerrjes së një njoftimi për shtypin dhe përmbajtjen e tij.

VI. Përmbajtja e mbledhjes së rregullt të GKSF-së

Në një mbledhje të rregullt të GKSF-së, sipas nevojës, autoritetet do të shkëmbejnë informacion rreth:

- a) *gjendjes së sistemit financiar dhe vlerësimit të rreziqeve*, ku:
 - i. BSH do të paraqesë një pamje të gjendjes financiare dhe të rreziqeve të sektorit bankar;
 - ii. AMF do të paraqesë ecurinë financiare të institucioneve që mbikëqyr dhe një vlerësim mbi ekspozimin e tyre në marrëdhëniet me sektorin bankar ose segmente të tjera të sistemit financiar;
 - iii. ASD do të paraqesë një informacion mbi nivelin e likuiditetit të fondit të kompensimit;
 - iv. MF do të paraqesë një vlerësim mbi gjendjen e ekonomisë reale, ecurinë e zërave kryesorë të buxhetit dhe ecurinë e financimit të borxhit;

- b) *kapaciteteve/instrumenteve për përballimin e një situatë të jashtëzakonshme financiare*, ku:
 - i. BSH do të bëjë një vlerësim për përshtatshmërinë e instrumenteve që ka në dispozicion për të përballuar një situatë të jashtëzakonshme financiare në sektorin bankar dhe institucionet e tjera që mbikëqyr;
 - ii. AMF do të bëjë një vlerësim për përshtatshmërinë e instrumenteve që ka në dispozicion për të përballuar një situatë të jashtëzakonshme financiare në sektorin financiar jo-bankar;
 - iii. ASD do të bëjë një vlerësim për gatishmërinë e saj për përmbushjen e menjëhershme të procedurave lidhur me kompensimin e depozitave;
 - iv. MF do të bëjë një vlerësim të ndikimit dhe të hapësirës që ekziston në buxhetin e qeverisë si një hallkë e fundit, për të administruar një situatë të jashtëzakonshme financiare që kërcënon stabilitetin e sistemit financiar;
 - v. autoritetet do të trajtojnë problemet që mund të lindin si rezultat i integritetit të tregjeve financiare vendase në tregjet financiare ndërkombëtare
 - vi. dhe ndërlikimeve që kjo mund të sjellë për shkak të nevojës/vështirësive për bashkëpunim me autoritetet homologe të huaja.

- c) *nismave/projekteve që ndikojnë në mënyrë të rëndësishme veprimtarinë e sistemit financiar*, duke përfshirë reformat rregullatore dhe ligjore. Në këtë kuadër, Autoritetet do të mbështesin njëri-tjetrin për përgatitjen e projektligjeve apo të projektvendimeve dhe përcjelljen e tyre në Këshillin e Ministrave.

VII. Përmbajtja e mbledhjes së posaçme të GKSF-së

1. Në mbledhjen e posaçme të GKSF-së:

a) autoriteti përgjegjës:

- i. do të fokusojë përmbajtjen e informacionit tek rreziku i shfaqur, tek potenciali i tij për t'u shndërruar në rrezik sistemik;
- ii. do të vlerësojë mundësitë që ekzistojnë për shpejtësinë e zhvillimit të këtij rreziku përgjatë kohës, për kufizimin ose për shtrirjen e tij në segmente të tjera të sistemit financiar dhe ndikimin në tregje të ndryshme, si edhe për ndërlikime të tjera;
- iii. do të vlerësojë mundësitë që ekzistojnë që kjo situatë të ndikojë në sjelljen e publikut;
- iv. do të informojë autoritetet e tjera mbi veprimet që ka kryer ose që mendon të kryejë në të ardhmen e afërt, si edhe mbi dispozicionin dhe vlefshmërinë e mekanizmave të ndryshëm ligjorë për trajtimin e situatës;
- v. do të vlerësojë nevojën për veprime të tjera nga Autoritetet;

b) mbi bazën e informacionit të autoritetit përgjegjës, autoritetet e tjera:

- i. do të vlerësojnë përmasën e rrezikut dhe mundësinë e shtrirjes së tij;
- ii. do të vlerësojnë nevojën për informacion shtesë dhe do të përcaktojnë mënyrën e mbledhjes së tij;
- iii. do të informojnë institucionet e tjera shtetërore për zhvillimet dhe rrezikun përkatës;
- iv. do të vlerësojnë nevojën dhe do të përgatisin sa më shpejt ndryshimet ligjore, rregullative dhe operacionale, për përballimin e situatës së jashtëzakonshme financiare;
- v. do të vlerësojnë strategjinë e komunikimit me publikun, median dhe agjentët e tjerë ekonomikë, duke synuar që informacioni të jepet në mënyrë të saktë, të harmonizuar, me periodicitetin e nevojshëm dhe në përshtatje me zhvillimet e situatës;
- vi. do të informojnë autoritetet homologe të huaja ose institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe do të kërkojnë ndihmën ose bashkëpunimin e tyre në rastin e një situatë të jashtëzakonshme financiare, që ka rrjedhur prej zhvillimeve ndërkombëtare ose që ka ndërlikime të tilla.

2. Krahas veprimeve të përcaktuara në paragrafin 1, Autoritetet do të shqyrtojnë marrjen e masave të tjera që do t'i shërbenin zgjidhjes me efektivitet të një situatë të jashtëzakonshme financiare që kërcënon stabilitetin e sistemit financiar.

VIII. Administrimi i informacionit

1. Në vazhdimësi, për të mbështetur analizën dhe bashkëpunimin sipas fushave të kompetencës, Autoritetet do të organizojnë, ruajnë përditësojnë rregullisht informacionin mbi institucionet financiare (posaçërisht për ato me rëndësi sistemike) ku, minimalisht, përfshihen:
 - a) organizimi ligjor, i marrëdhënieve të pronësisë dhe i strukturës drejtuese;
 - b) të dhënat e bilancit dhe përbërja e mjeteve dhe detyrimeve;
 - c) treguesit e kapitalizimit, të përfitueshmërisë dhe të likuiditetit;
 - d) ekspozimet ndaj institucioneve të tjera financiare, infrastrukturës kritike dhe segmenteve të caktuara të tregjeve;
 - e) peshën dhe ndikimin në treg, në ekonominë reale, ekspozimet ndërsektoriale, kushtet e likuiditetit në tregje etj.;
 - f) të dhëna të tjera për zhvillime që cenojnë aftësinë e tyre për të vepruar në mënyrë të shëndetshme e të sigurt.
2. Në rastin e shkëmbimit të informacionit, Autoriteti që e merr atë sigurohet që ai përdoret vetëm për përmbushjen e përgjegjësisë së tij dhe nuk u përcillet palëve të treta pa njoftuar më parë autoritetin origjinar të informacionit, me përjashtim të rasteve kur kjo gjë lejohet me ligj.

IX. Interpretimi, ndryshimi dhe hyrja në fuqi e Memorandumit

1. Interpretimet e ndryshme që mund të lindin gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, do të zgjidhen nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë dhe mirëkuptimit mes palëve.
2. Çdo ndryshim i këtij Memorandumi do të kryhet me shkrim dhe me konsensusin e palëve të tij. Ndryshimi do të hyjë në fuqi në datën kur Memorandumi i ndryshuar nënshkruhet nga palët ose në një datë tjetër të miratuar nga palët nënshkruese. Secila palë, duhet t'i përgjigjet propozimit me shkrim për rregullime ose ndryshime të bëra nga një palë tjetër, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së këtij propozimi.
2. Ky Memorandum u nënshkrua nga palët në datën **10 mars 2014** dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.
3. Me hyrjen në fuqi, ky Memorandum zëvendëson, duke e bërë të pavlefshëm, Memorandumin e Mirëkuptimit mes MF, BSH, AMF dhe ASD "Për bashkëpunimin në drejtim të zhvillimit të sistemit financiar dhe parandalimit e administrimit të situatave të jashtëzakonshme në veprimtarinë e tregjeve dhe të subjekteve financiare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, të cilat mund të kërcënojnë stabilitetin e sistemit financiar të vendit (më poshtë, rreziqe sistemike)", të regjistruar:

- a) në MF, me nr.1412/1, datë 03.02.2012; dhe
 - b) në BSH, me nr.422/1, datë 27.01.2012; dhe
 - c) në AMF, me nr.255, datë 09.02.2012; dhe
 - d) në ASD, me nr.110, datë 10.02.2012.
4. Ky Memorandum, hartohet në katër kopje origjinale me vlerë të barabartë dhe secila nga palët mban një kopje të tij.

MINISTRIA E FINANCAVE

Shkëlqim CANI

Ministër
(*firma, vula*)

BANKA E SHQIPËRISË

Ardian FULLANI

Guvernator
(*firma, vula*)

AUTORITETI I MBIKËQYRJES
FINANCIARE

Enkeleda SHEHI

Kryetare
(*firma¹, vula*)

AGJENCIA E SIGURIMIT TË
DEPOZITAVE

Toni GOGU

Drejtor i Përgjithshëm
(*firma, vula*)

¹ Me autorizimin e Kryetares, dokumenti është nënshkruar nga zj.Enkela Idrizi, Nënkyetare.

Aneks 1:

PROCEDURAT E FUNKSIONIMIT TË SEKRETARIATIT TË GKSF-së

I. Baza e krijimit të Sekretariatit

Në zbatim të kapitullit V, paragrafit 4 të Memorandumit dhe në kuadër të mbështetjes së punës së GKSF-së, krijohet Sekretariati.

II. Funkcionet e Sekretariatit

1. Në mbështetje të punës dhe në përputhje me orientimet e GKSF-së, Sekretariati shërben si një strukturë e cila, nëpërmjet anëtarëve:
 - a. kërkon, mbledh, shpërndan dhe administron informacionin, që shërben si bazë e diskutimeve në mbledhjet e GKSF-së tek autoritetet;
 - b. sipas nevojës dhe mundësisë, prezanton materiale të ndryshme në mbledhjen e GKSF-së;
 - c. ndjek zbatimin e Memorandumit.
2. Për të përmbushur funksionin e tij, Sekretariati, nëpërmjet anëtarëve të tij:
 - a. vendos dhe ruan komunikim të rregullt me strukturat e nevojshme të autoriteteve, me GTM dhe me grupet e përbashkëta të punës që krijohen me rekomandim të GKSF-së;
 - b. orienton formën dhe përmbajtjen e informacioneve që vijnë nga autoritetet dhe grupet e përbashkëta të punës, në funksion të përmirësimit të efektivitetit të mbledhjeve të GKSF-së;
 - c. sugjeron çështje për t'u shqyrtuar në mbledhjen e GKSF-së;
 - d. ndjek ecurinë e rekomandimeve që kanë dalë nga mbledhja e GKSF-së;
 - e. mban minutat/procesverbalin e mbledhjes dhe ruan dokumentacionin e çështjeve të diskutuara në mbledhjet e GKSF-së.
3. Autoritetet ndihmojnë në përmbushjen e funksionit të Sekretariatit, nëpërmjet mbështetjes që japin me strukturat e tyre të brendshme.

III. Përbërja e Sekretariatit

1. Sekretariati do të ketë përbërjen e mëposhtme:
 - 3 punonjës nga Banka e Shqipërisë;
 - 2 punonjës nga Ministria e Financave;
 - 2 punonjës nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
 - 2 punonjës nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.
2. Një përfaqësues i Bankës së Shqipërisë ushtron funksionin e Kryetarit të Sekretariatit. Një përfaqësues i Ministrisë së Financave ushtron funksionin e

Nënkryetarit të Sekretariatit, si dhe rolin e Kryetarit të Sekretariatit në mungesë të tij.

3. Për përmbushjen e funksionit të Sekretariatit, anëtarët e tij do të kenë detyra të ndryshme dhe do të bashkëpunojnë e harmonizojnë veprimet për realizimin e tyre.
4. Autoritetet përcaktojnë nominalisht punonjësit e tyre që do t'i përfaqësojnë në Sekretariat dhe rolin përkatës.

IV. Roli i Kryetarit të Sekretariatit

Me qëllim përmbushjen e funksionit të Sekretariatit, Kryetari i tij kryen këto veprime:

- a. merr pjesë në mbledhjet e GKSF-së dhe të GTM-së;
- b. përfaqëson Sekretariatit në komunikimin me autoritetet;
- c. organizon punën e anëtarëve të Sekretariatit, duke caktuar detyra, koordinuar veprimet dhe lehtësuar bashkëpunimin mes tyre;
- d. ruan komunikim të rregullt me drejtuesit e autoriteteve, në kuadër të trajtimit të çështjeve që diskutohen në GKSF dhe për përmirësimin e funksionimit të Sekretariatit;
- e. propozon, jep opinione dhe paraqet çështje të ndryshme që trajtohen në mbledhjet e GKSF-së dhe të GTM-së.

V. Veprimet e Sekretariatit për mirëfunksionimin e mbledhjes së GKSF-së

1. Për mirëfunksionimin e një mbledhjeje të rregullt të GKSF-së, anëtarët e Sekretariatit kryejnë këto veprime:

- *përpara mbledhjes:*

- a. Kryetari dhe Nënkryetari i Sekretariatit, nëpërmjet konsultimit me drejtuesit e autoriteteve ose personat e autorizuar prej tyre, përcaktojnë:
 - i. datën e zhvillimit dhe vendin e mbledhjes;
 - ii. programin e mbledhjes së GKSF-së dhe natyrën e sasinë e informacionit që do të trajtohet në mbledhje;
- b. Kryetari i Sekretariatit njofton drejtuesit e autoriteteve ose personat e autorizuar prej tyre, për programin e mbledhjes dhe orienton për materialet që ata duhet të paraqesin të paktën 20 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes;
- c. të paktën 7 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes, anëtarët e Sekretariatit komunikojnë me autoritetet për të mbledhur materialet që ato duan/mund të paraqesin në mbledhje;
- d. anëtarët e Sekretariatit, në koordinim me autoritetet që përfaqësojnë, mund të përgatisin dhe prezantojnë materiale të ndryshme në mbledhjen e GKSF-së;

- e. të paktën 3 ditë përpara mbledhjes, shpërndajnë tek drejtuesit e autoriteteve ose personat e autorizuar prej tyre, materialet që do të diskutohen në mbledhje, në përputhje me programin e përcaktuar;
- f. sipas nevojës, sigurojnë kopje të printuara të materialeve të mbledhjes për të pranishmit;

- *gjatë mbledhjes:*

- g. marrin pjesë në mbledhje;
- h. Kryetari dhe Nënkryetari i Sekretariatit sigurojnë respektimin e programit të mbledhjes;
- i. një anëtar i Sekretariatit, mban minutat/procesverbalin e mbledhjes dhe evidenton rekomandimet që dalin nga mbledhja;
- j. nëse autorizohen nga autoritetet gjatë mbledhjes, anëtarët e Sekretariatit përgatisin njoftimin për shtyp rreth mbledhjes dhe komunikimin me institucionet e tjera;

- *pas mbledhjes:*

- k. anëtarët e Sekretariatit ndjekin publikimin e njoftimit për shtyp të mbledhjes, me të njëjtën përmbajtje, në faqet elektronike të autoriteteve dhe sigurohen që kjo ndodh jo më vonë se 1 ditë pune pas ditës së mbledhjes;
 - l. kryetari i Sekretariatit, brenda 3 ditëve pune nga përfundimi i mbledhjes, shpërndan tek drejtuesit e autoriteteve minutat e mbledhjes, duke identifikuar qartësisht rekomandimet e dala prej saj dhe kur është e mundur, datën paraprake të mbledhjes së ardhshme;
 - m. anëtarët e Sekretariatit ruajnë elektronikisht dhe/ose arkivojnë, materialet e shqyrtuara në mbledhje dhe minutat/procesverbalin e saj.
2. Të gjitha veprimet e parashikuara në paragrafin 1, do të s kryhen edhe në rastin e organizimit të mbledhjeve të posaçme të GKSF-së në një formë të përshtatur, për aq sa lejon koha në dispozicion të organizimit të mbledhjes dhe nuk bie në kundërshtim me nevojën parësore për zhvillimin e shpejtë të saj.

VI. Mënyra e komunikimit

Si rregull, komunikimi i Sekretariatit me përfaqësuesit e autoriteteve dhe lëvizja e materialeve të mbledhjes, do të kryhet nëpërmjet postës elektronike. Në rastet kur rekomandohet e nevojshme nga njëri prej autoriteteve për shkak të rrethanave dhe çështjeve që diskutohen në mbledhje, komunikimi do të kryhet vetëm në formë shkresore.

VII. Statusi i informacionit që shfrytëzohet në mbledhjet e GKSF-së

1. Si rregull, çdo informacion që shfrytëzohet në mbledhjet e GKSF-së, çdo material që diskutohet, si edhe komunikimi rreth tyre konsiderohet "i rezervuar" dhe nuk publikohet. Në mbledhjet e GKSF-së, autoritetet përcaktojnë informacionin që mund të bëhet publik dhe/ose shkëmbehet me palë të treta, si edhe mënyrën e realizimit.
2. Në rastin e publikimit, përfaqësuesi i Sekretariatit bën një përmbledhje të informacionit që mund të publikohet, e konsulton me autoritetet dhe më pas e dërgon për publikim në faqet zyrtare të internetit të secilit autoritet.

Aneks 2:

PROCEDURAT E FUNKSIONIMIT TË GRUPIT TEKNIK MBËSHTETËS

I. Baza e krijimit të Grupit Teknik Mbështetës

Grupi Teknik Mbështetës, në vijim referuar "GTM", krijohet në zbatim të kapitullit V, paragrafi 5 të Memorandumit, për të mbështetur veprimtarinë e GKSF-së.

II. Funkcionet e GTM-së

1. GTM, kryen këto funksione:

- a. identifikon dhe diskuton rreth zhvillimeve më të fundit në sistemin financiar dhe vlerëson rregullisht rreziqet potenciale që rrjedhin prej tyre;
- b. vlerëson ecurinë e rekomandimeve të GKSF-së;
- c. mbështet me informacion dhe opinione çështjet që diskuton GKSF;
- d. propozon tek Sekretariati çështje të ndryshme për diskutim në mbledhjet e GKSF-së.

2. Për mirëfunksionimin e tij, GTM koordinon punën me Sekretariatën.

III. Anëtarët e GTM

Anëtarë të GTM janë:

- a. Zëvendësministri i Ministrisë së Financave;
- b. Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë;
- c. Nënkryetari i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;

IV. Mbledhja e GTM-së

1. Mbledhja zhvillohet çdo muaj, si rregull, ditën e enjte të javës së tretë të muajit. Në muajin që realizohet mbledhja e rregullt e GKSF-së, mbledhja e GTM-së zhvillohet disa ditë përpara saj.
2. Si rregull, mbledhja zhvillohet në mjediset e Ministrisë së Financave ose të Bankës së Shqipërisë. Mbledhja mund të zhvillohet në selitë e secilit prej anëtarëve të tjerë, pas kërkesës së tyre dhe pëlqimit nga të gjithë anëtarët.

3. Anëtarët mund të delegojnë pjesëmarrjen në mbledhje jo më shumë se dy herë gjatë vitit. Në këto raste, në mbledhje duhet të jetë i pranishëm të paktën Zëvendësministri i Ministrisë së Financave ose Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë;
4. Anëtarët e GTM-së mund të shoqërohen në mbledhje nga personeli ndihmës.
5. Në mbledhjen e GTM-së merr pjesë edhe Kryetari i Sekretariatit.
6. Programi i mbledhjes koordinohet dhe përgatitet nga Sekretariati, në konsultim me anëtarët e GTM-së.
7. Njoftimi dhe programi i mbledhjes, i dërgohen paraprakisht edhe zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të ASD, me qëllim që:
 - a. të sigurojë përfaqësimin në mbledhje të institucionit nëse e gjykon të nevojshme ose kur ftohet nga anëtarët e GTM-së;
 - b. të propozojë ose të konfirmojë çështje për diskutim në programin e mbledhjes, në rastin e përfaqësimit në mbledhje të ASD-së.
8. Anëtarët e GTM-së, dhe sipas rastit edhe ASD, sigurojnë përgatitjen e materialeve që nevojiten në përputhje me programin e mbledhjes dhe ia dërgojnë përfaqësuesit të Sekretariatit për t'i përgatitur për paraqitje në mbledhje, si rregull, jo më vonë se 2 ditë para saj.
9. Në përfundim të mbledhjes, përfaqësuesi i Sekretariatit përgatit dhe shpërndan tek pjesëmarrësit në mbledhje minutat e mbledhjes dhe siguron ruajtjen e tyre.

V. Vendimmarrja në mbledhje

1. Në mbledhjet e GTM-së, pjesëmarrësit shfaqin opinionet e tyre lidhur me çështjet që diskutohen.
2. Për shkak të natyrës së çështjeve që trajtohen dhe rolit të GTM-së, në mbledhje nuk votohet.
3. Qëndrimet që formulohen në mbledhje, synojnë të mbështeten në konsensusin e të pranishmëve.

VI. Mënyra e komunikimit dhe ruajtjes së informacionit

1. Si rregull, komunikimi i përfaqësuesit të Sekretariatit me pjesëmarrësit në mbledhje dhe lëvizja e materialeve të mbledhjes, do të kryhet nëpërmjet

postës elektronike. Në këtë rast, ruajtja e materialeve bëhet në formë elektronike nga Sekretariati.

2. Në rastet kur njëri nga anëtarët e gjykon të domosdoshëm për shkak të rrethanave të një çështjeje ose një mbledhjeje të caktuar, komunikimi do të kryhet dhe ruhet vetëm në formë shkresore.

VII. Statusi i informacionit që shfrytëzohet në mbledhjet e GTM-së

1. Si rregull, çdo informacion që shfrytëzohet në mbledhjet e GTM-së, çdo material që diskutohet, si edhe komunikimi rreth tyre, konsiderohet "i rezervuar" dhe nuk publikohet.
2. Nëse në mbledhje gjykohet ndryshe nga sa thuhet në paragrafin 1, anëtarët e GTM-së përcaktojnë pjesën e informacionit dhe të diskutimeve që mund të publikohen.
3. Në rastin e paragrafit 2, përfaqësuesi i Sekretariatit bën një përmbledhje të informacionit që mund të publikohet, e konsulton me pjesëmarrësit në mbledhje dhe më pas e dërgon për publikim në faqet zyrtare të internetit të secilit autoritet.